



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 29.01.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Ceremonia e betimit të gjyqtarëve të emëruar më datë 09.01.2020.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 12:01.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>11. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënive me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
7. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
8. *Gregor Borkoëski, EURALIUS.*
9. *Anisa Kuçi, EURALIUS.*
8. *Valbona Bala, USAID.*
9. *Julinda Karaboja, USAID.*
10. *Charles Ericksen, USAID.*
11. *Magjistratët profili gjyqtar dhe profili prokuror.*
12. *Përfaqësues të medias.*

## **RENDI I DITËS:**

1. Ceremonia e betimit të gjyqtarëve të emëruar më datë 09.01.2020.

*Naureda Llagami:* Atëherë, përshëndetje të gjithëve!

Siç jeni vënë në dijeni, sot Këshilli i Lartë Gjyqësor do të bëjë mbledhjen e radhës, e cila për shkak të rëndësisë është një mbledhje që i është dedikuar ceremonisë së betimit të magjistratëve/gjyqtarëve të emëruar që kanë mbaruar vitin akademik në 2018-2019.

Pra sot, kam kënaqësinë që në emër të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të hap ceremoninë e betimit të magjistratëve të rinj, të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2018-2019.

Juve jeni brezi i dytë i magistratëve për të cilën ky Këshill ka realizuar një proces të mirëfilltë verifikimi. Të gjithë ju sot ia dolët me sukses, jo vetëm në marrjen e njohurive, dijeve dhe aftësive për të qenë një gjyqtar i aftë, por të gjithë keni kaluar një proces të thelluar të verifikimit të pasurisë dhe figurës për të qenë një gjyqtar me vlera dhe individ me integritet.

Sot dua t'ju them edhe në emër të të gjithë kolegëve, se ne kemi besim te ju, ne kemi nevojë për ju në çdo gjykatë, por edhe në çdo komunitet; kemi nevojë për besimin dhe përkushtimin tuaj te drejtësia, besnikërinë tuaj në punën e përditshme, ashtu edhe në sfidat profesionale për respektimin ndaj Kushtetutës dhe ligjit.

E filluam vitin e kaluar me emërimin e 10 gjyqtarëve të rinj. E nisim këtë vit të ri me ju, brezin e dytë të të diplomuarve. Sot bëhen 25 gjyqtarë të rinj, të një drejtësie të re, të një drejtësie e cila reflekton aspiratat tona për një vend, një shoqëri dhe një të ardhme evropiane. Mendoj se jemi në rrugën e duhur dhe kjo pa diskutim që nuk do jetë një rrugë e lehtë për ju, por besoj që ju keni entuziazmin e duhur për ta ndjekur. Jo vetëm ne si pjesë e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe që e kemi për detyrim ligjor mbështetjen dhe rritjen tuaj profesionale, por të gjithë kolegët tuaj nëpër gjykata, të gjithë qytetarët, presin një model të ri. Jam e bindur se me ju, hap pas hapi, fillon një ndryshim cilësor, që fillon sot dhe do të zgjasë disa dhjetëvjeçarë të jetës tuaj profesionale.

Ju uroj të jeni pjesa më e mirë e këtij ndryshimi, kudo që do t'i shërbeni drejtësisë dhe qytetarëve.

Ju uroj suksese!

Pa humbur kohë, unë do doja që t'i ftoja gjyqtarët sipas radhës, për të bërë betimin, dhe ftoj edhe punonjësën e administratës për të lexuar formulën e betimit dhe magistrati do të betohet, duke vendosur dorën në Kushtetutë.

Atëherë, fillojmë me zonjës Erlanda Agaj.

**Elis Kuçi:** “Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t'i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do respektoj rregullat e etikës profesionale”.

*(Gjyqtarja Erlanda Agaj betohet, por nuk dëgjohe për shkak se nuk ka të ndezur mikrofonin.)*

*(Ftohet më pas zoti Marko Boshku.)*

**Elis Kuçi:** “Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do respektoj rregullat e etikës profesionale”.

*(Gjyqtari Marko Boshku betohet, por nuk dëgjohe për shkak se nuk e ka ndezur mikrofonin.)*

**Naureda Llagami:** Ftoj zonjës Elisabeta Gjoni.

**Elis Kuçi:** “Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do respektoj rregullat e etikës profesionale”.

**Elisabeta Gjoni:** Betohem!

**Naureda Llagami:** Ftoj zotin Mirjan Mustafaj.

**Elis Kuçi:** “Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do respektoj rregullat e etikës profesionale”.

**Mirjan Mustafaj:** Betohem!

**Naureda Llagami:** Ftoj zonjën Kostandina Kuro.

**Elis Kuçi:** “Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do respektoj rregullat e etikës profesionale”.

**Kostandina Kuro:** Betohem!

**Naureda Llagami:** Ftoj zonjën Klejda Çapja.

**Elis Kuçi:** “Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do respektoj rregullat e etikës profesionale”.

**Klejda Çapja:** Betohem.

**Naureda Llagami:** Ftoj zonjën Iva Zemani.

**Elis Kuçi:** “Betohe më së do të kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do respektoj rregullat e etikës profesionale”.

**Iva Zemani:** Betohe më.

**Naureda Llagami:** Ftoj zonjën Enisa Shahini.

**Elis Kuçi:** “Betohe më së do të kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do respektoj rregullat e etikës profesionale”.

**Enisa Shahini:** Betohe më.

**Naureda Llagami:** Ftoj zotin Artur Prenga.

**Elis Kuçi:** “Betohe më së do të kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do respektoj rregullat e etikës profesionale”.

**Artur Prenga:** Betohe më.

**Naureda Llagami:** Ftoj zotin Ligoraq Toshi.

**Elis Kuçi:** “Betohe më së do të kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do respektoj rregullat e etikës profesionale”.

**Ligoraq Toshi:** Betohe më.

**Naureda Llagami:** Ftoj zotin Hazbi Balliu.

**Elis Kuçi:** “Betohe më së do të kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do respektoj rregullat e etikës profesionale”.

**Hazbi Balliu:** Betohe më.

**Naureda Llagami:** Ftoj zonjën Ema Shaholli.

**Elis Kuçi:** “Betohe më së do të kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do respektoj rregullat e etikës profesionale”.

**Ema Shaholli:** Betohe më.

**Naureda Llagami:** Ftoj zotin Shkëlzen Liçaj.

**Elis Kuçi:** “Beto hem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do respektoj rregullat e etikës profesionale”.

**Shkëlzen Liçaj:** Beto hem.

**Elis Kuçi:** “Beto hem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do respektoj rregullat e etikës profesionale”.

**Naureda Llagami:** Ftoj zotin Florin Demollari.

**Elis Kuçi:** “Beto hem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do respektoj rregullat e etikës profesionale”.

**Florin Demollari:** Beto hem.

**Naureda Llagami:** Ftoj zotin Xhevdet Lika.

**Elis Kuçi:** “Beto hem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do respektoj rregullat e etikës profesionale”.

**Xhevdet Lika:** Beto hem.

*(Ndërkohë ftohen të dalin nga salla e mbledhjes kameramanët, për të vijuar më tej me rendin e ditës.)*

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 29.01.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 06.12.2019, 10.12.2019, 16.12.2019, 18.12.2019, 19.12.2019, 20.12.2019 dhe 24.12.2019.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 12:01.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

*11. Marçela Shehu*

*(anëtare)*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 9. Anisa Kuçi, EURALIUS.*
- 8. Valbona Bala, USAID.*
- 9. Julinda Karaboja, USAID.*
- 10. Charles Ericksen, USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 06.12.2019, 10.12.2019, 16.12.2019, 18.12.2019, 19.12.2019, 20.12.2019 dhe 24.12.2019.

*Naureda Llagami:* Atëherë, duke vijuar me çështjet sipas rendit të ditës.

Siç jeni vënë në dijeni, përveç ceremonisë së betimit, sot në rend të ditës janë projektvendimi lidhur me caktimin e të gjithë gjyqtarëve, dhe është miratimi i procesverbaleve për mbledhjet respektive, që stafi administrativ jua ka shpërndarë dhe; unë propozoj, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, të shtohet në rend të



ditës edhe një projektvendim lidhur me korigjimin e gabimit me shkrim në vendimin nr. 31, datë 23.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Jeni dakord me këtë rendin e ditës dhe me shtesën e bërë?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Atëherë, kalojmë fillimisht me miratimin e procesverbaleve?

Kemi ndonjë?

Nuk kemi! Kalojmë në votim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro. Me përjashtim të procesverbalit të datës 24.12.2019, ku nuk kam qenë prezent.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 06.12.2019, 10.12.2019, 16.12.2019, 18.12.2019, 19.12.2019, 20.12.2019 dhe 24.12.2019.

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbajtur, më 29.01.2020)***

***Pika 3 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimeve lidhur me caktimin në pozicion të të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 09.01.2020, të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, si më poshtë:

1. “Për caktimin në pozicion të znj. Erlanda Agaj”;
2. “Për caktimin në pozicion të z. Marko Boshku”;
3. “Për caktimin në pozicion të znj. Elisabeta Gjoni”;
4. “Për caktimin në pozicion të z. Mirjan Mustafaj”;
5. “Për caktimin në pozicion të znj. Kostandina Kuro”;
6. “Për caktimin në pozicion të zn. Klejda Çapja”;
7. “Për caktimin në pozicion të znj. Iva Zemani”;
8. “Për caktimin në pozicion të znj. Enisa Shahini”;
9. “Për caktimin në pozicion të z. Artur Prenga”;
10. “Për caktimin në pozicion të z. Ligoraq Toshi”;
11. “Për caktimin në pozicion të z. Hazbi Balliu”;
12. “Për caktimin në pozicion të znj. Ema Shaholli”;
13. “Për caktimin në pozicion të z. Shkëlzen Liçaj”;
14. “Për caktimin në pozicion të z. Florin Demollari”;
15. “Për caktimin në pozicion të z. Xhevdet Lika”.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 12:01.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i>   | <i>(kryetare)</i>        |
| <i>2. Maksim Qoku</i>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i>         | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>4. Fatmira Luli</i>      | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>5. Brunilda Kadi</i>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i>   | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>7. Ilir Toska</i>        | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>8. Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>11. Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i>         |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 9. Anisa Kuçi, EURALIUS.*

**8. Valbona Bala, USAID.**

**9. Julinda Karaboja, USAID.**

**10. Charles Ericksen, USAID.**

**RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimeve lidhur me caktimin në pozicion të të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 09.01.2020, të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, si më poshtë:

1. “Për caktimin në pozicion të znj. Erlanda Agaj”;
2. “Për caktimin në pozicion të z. Marko Boshku”;
3. “Për caktimin në pozicion të znj. Elisabeta Gjoni”;
4. “Për caktimin në pozicion të z. Mirjan Mustafaj”;
5. “Për caktimin në pozicion të znj. Kostandina Kuro”;
6. “Për caktimin në pozicion të zn. Klejda Çapja”;
7. “Për caktimin në pozicion të znj. Iva Zemani”;
8. “Për caktimin në pozicion të znj. Enisa Shahini”;
9. “Për caktimin në pozicion të z. Artur Prenga”;
10. “Për caktimin në pozicion të z. Ligoraq Toshi”;
11. “Për caktimin në pozicion të z. Hazbi Balliu”;
12. “Për caktimin në pozicion të znj. Ema Shaholli”;
13. “Për caktimin në pozicion të z. Shkëlzen Liçaj”;
14. “Për caktimin në pozicion të z. Florin Demollari”;
15. “Për caktimin në pozicion të z. Xhevdet Lika”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktet që kanë të bëjnë me caktimin në pozicion të gjyqtarëve. Fillojmë me projekt-aktin e parë që ka të bëjë me caktimin në

pozicion të gjyqtarës së emëruar, zonjën Erlanda Agaj. Relatimi i këtij projekt-akti do të bëhet nga zoti Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur 15 projektvendime për caktimin në pozicion të 15 gjyqtarëve të emëruar në datë 9 janar të viti 2020. Për të gjitha projektvendimet kemi përgatitur një relacion shpjegues, mbasi ezauron të gjitha çështjet që do duhet të mbahen në vëmendje.

Atëherë, sikurse jeni në dijeni emërimi i magjistratëve të rinj dhe caktimi në pozicion i tyre ka qenë prioritet i punës së Këshillit Lartë Gjyqësor kjo, jo vetëm për shkak të detyrimit ligjor, por dhe për shkak të nevojave që kanë gjykatat për gjyqtarë. Emërimi i tyre dhe caktimi në pozicion ka një procedurë të mirëpërcaktuar në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Këshilli, pasi përfundoi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtarë të kandidatëve të cilët kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019, bazuar në vendimin e tij nr. 75/2019, në mbledhjen e tij të datës 09.01.2020 bëri emërimin e tyre gjyqtar, mbështetur në nenin 35 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithashtu Këshilli, duke mbajtur parasysh numrin e gjyqtarëve të emëruar më datë 09.01.2020, pozicionet e lira në sistemin gjyqësor dhe numrin minimal të gjyqtarëve të përcaktuar nga ligji për gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe administrativ, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, me vendimin nr.25 datë 14.01.2020, shpalli 15 pozicione të lira për të aplikuar gjyqtarët e emëruar në mbledhjen e datës 9 janar 2020.

Legjislacioni në fuqi, konkretisht neni 39, pika 3, e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi thekson që gjyqtarët e diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, pas emërimit të tyre si gjyqtar, kanë përparësi në caktimin e tyre në pozicion, parashikon që ky caktim bëhet duke respektuar kriteret si vijon:

a) renditjen e tyre në listën e të diplomuarve, të bërë nga Shkolla e Magjistraturës, bazuar në rezultatet e provimeve gjatë vitit të parë dhe të dytë, provimit përfundimtar, si dhe vlerësimet gjatë praktikës profesionale;

b) përmbushjen e preferencave të deklaruara nga të diplomuarit në formimin fillestar, për tri gjykata.

Pra, kriteri kryesor për caktimin në pozicion të të emëruarve është renditja e bërë nga Shkolla e Magjistraturës bazuar në rezultatet e tyre të studimeve. Konkretisht, sipas listës së dërguar nga Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr.625 prot., datë 03.07.2019, renditja e të diplomuarve është kjo:

1. Erlanda Agaj;
2. Marko Boshku;
3. Elisabeta Gjoni;
4. Mirjan Mustafaj;
5. Kostandina Kuro;
6. Klejda Çapja;
7. Iva Zemani;
8. Enisa Shahini;
9. Artur Prenga;
10. Ligorag Toshi;
11. Hazbi Balliu;
12. Ema Shaholli;
13. Shkëlzen Liçaj;
14. Florin Demollari dhë në fund;
15. Xhevdet Likaj.

Të gjithë gjyqtarët e emëruar më datë 9 janar 2020, kanë shprehur preferencat e tyre duke renditur tre pozicione të lira për caktim në detyrë, sipas tabelës bashkëlidhur.

Ndaj sa më sipër, bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën 3, të nenit 39, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në përmbushje të funksionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor sipas pikës 1, të nenit 147/a, të

Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe sipas shkronjës “b”, të nenit 86, të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës ka hartuar projektvendimet për caktimin në pozicion të secilit gjyqtar të emëruar në mbledhjen e datës 9 janar 2020.

Në këtë propozim Komisioni ka mbajtur në konsideratë së pari, renditjen e tyre në listën e të diplomuarve të miratuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe, së dyti, për aq sa ka qenë e mundur, preferencat e tyre. Vlen të përmendet se për 7 të emëruar, propozimi për caktimin në pozicion konsiston në preferencën e parë të tyre. Për 1 të emëruar tjetër, propozimi për caktimin në pozicion konsiston në preferencën e dytë të tij. Për 5 të emëruar, propozimi për caktimin në pozicion konsiston në preferencën e tretë të tyre. Vetëm për 2 të emëruar, propozimi për caktimin në pozicion nuk konsiston në asnjë nga preferencat e tyre, por, nga ana tjetër, propozimi konsideron preferencat e tyre të para sa i përket juridiksionit të gjykatave, konkretisht atij administrativ, ndërsa pozicionet e preferuara nga ata kanë qenë të tilla nga të emëruarit e renditur më lart se ata në listën e të diplomuarve.

Lidhur me caktimin në pozicion të të emëruarve në gjykatat administrative të shkallës së parë, Komisioni ka mbajtur në konsideratë edhe kërkesat e pikës 5, të nenit 39, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit “I emëruari që caktohet në pozicion në gjykatat administrative, duhet të ketë përvojë pune në të paktën një vit e gjysmë në administratën publike ose të ketë rezultate "shumë të mira" në lëndët e së drejtës administrative në Shkollën e Magjistraturës”.

Sa i përket kërkesave të pikës 5, të nenit 39, të ligjit nr. 96/2016, referuar përvojës në punë në administratën publike dhe rezultateve në lëndët e së drejtës administrative në Shkollën e Magjistraturës, Komisioni ka konsideruar se vetëm 8 nga të emëruarit plotësojnë këto kërkesa, konkretisht:

1. Erlanda Agaj (ka rezultate "shumë të mira" në lëndët e së drejtës administrative);



2. Marko Boshku (ka rezultate "shumë të mira" në lëndët e së drejtës administrative);

3. Mirjan Mustafaj (ka rezultate "shumë të mira" në lëndët e së drejtës administrative);

4. Klejda Çapja (ka rezultate "shumë të mira" në lëndët e së drejtës administrative);

5. Enisa Shahini (ka rezultate "shumë të mira" në lëndët e së drejtës administrative);

6. Ligoraq Toshi (ka përvojë pune në të paktën një vit e gjysmë në administratën publike);

7. Hazbi Balliu (po ashtu ka përvojë pune në të paktën një vit e gjysmë në administratën publike);

8. Ema Shaholli (ka përvojë pune në të paktën një vit e gjysmë në administratën publike).

Vlen të theksohet se, sipas shkronjës "a", pika 1, të nenit 41 të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, që përcakton të drejtat dhe detyrimet e të emëruarit", parashikohet se "I emëruari duhet të pranojë pozicionin e ofruar në përputhje me nenet 39 dhe 40, të këtij ligji, duke përfshirë: a) pozicionin që nuk është deklaruar në preferencat e tij; ...".

Ky është edhe relacioni shpjegues për 15 projektvendimet për caktimin në pozicion të gjyqtarëve të emëruar në datë 9 janar të vitit 2020.

Mund të kalojmë, nëse ka ndonjë diskutim apo nuk e di, por më pas do duhet të kalojmë një për një për secilin projektvendim. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me propozimet e Komisionit?

Nëse jo, atëherë kalojmë vetëm me propozimin e projektvendimeve për secilin gjyqtar.

**Ilir Toska:** Mirë atëherë, projektvendimi i parë është “Për caktimin në pozicion të gjyqtares së emëruar Erlanda Agaj” – Është propozuar që gjyqtarja e emëruar Erlanda Agaj caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit të tij.

Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. Erlanda Agaj sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Atëherë, jemi dakord me propozimin e bërë nga Komisioni?

Kalojmë në votim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi për caktimin në pozicion të gjyqtares së emëruar znj. Erlanda Agaj, sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Kalojmë tek projekt-akti tjetër.

**Ilir Toska:** Projektvendimi i dytë është “Për caktimin në pozicion të gjyqtarit të emëruar z. Marko Boshku” – Sipas këtij propozimi, Komisioni propozon që gjyqtari i

emëruar z. Marko Boshku caktohet në pozicion pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit të tij.

Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. Marko Boshku sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në votim propozimin e bërë të Komisionit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi për caktimin në pozicion të gjyqtarit të emëruar z. Marko Boshku, sipas propozimit që dha Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kalojmë tek projekt-akti tjetër i cili ka të bëjë me zonjën Elisabeta Gjoni.

**Ilir Toska:** Atëherë, projektvendimi i radhës është “Për caktimin në pozicion të gjyqtarës së emëruar znj. Elisabeta Gjoni” – Sipas këtij propozimi, Këshillit i propozohet që gjyqtarja e emëruar znj. Elisabeta Gjoni caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit të tij.

Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. Elisabeta Gjoni sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në votim të projektpropozimit bërë nga Komisioni.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e vendimit për caktimin në pozicion të gjyqtares së emëruar znj. Elisabeta Gjoni, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

